

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA

BOJË AKRIL-SILOSANIKE RIEMPITIVA SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË JASHTME ANTIMYK ANTIALGA

seri 634

PËRSHKRIMI

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA është mbrojtës për sipërfaqe murale të jashtme me bazë rezinë akril-silosanike në dipersion uhor dhe inerte (agregate) riempitive. Ideale për lyerjen e sipërfaqeve cappoto, të lyera më parë.

E pajisur me karakteristika si, rezistencë e lartë ndaj ujit, traspirante e mirë e avujve të ujit, rezistencë e lartë ndaj larjes, rezistencë ndaj agentëve atmosferikë dhe ndotësve dhe ambienteve tipike alkaline të sipërfaqeve në çimento dhe në përgjithësi të suvave.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

- Suvatime të reja dhe të vjetra.
 - Sipërfaqe betoni.
 - Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
 - Sipërfaqe me natyrë të ndryshme minerale me kusht që të jenë absorbuese.
- Sipërfaqet përgatiten përshtatshëm duke ndjekur udhëzimet në paragrafin "Përgatitja e Sipërfaqes".
- Mos aplikoni në sipërfaqe të pathara mirë/freskëta dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të përshtatshme maturimi (tharje), përgjithësisht prej 4 javësh.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Foma lidhëse: Kopolimer akrilik me modifikime silosanike në emulsion uhor.
- Klasifikimi UNI EN 1062-1: (bojë për jashtë)
- Shkëlqimi EN ISO 2813: klasi G3 (<10, opaco)
- Trashësia e filmit të tharë ISO 3233: klasi E3 (100-200 µm)
- Granulometria EN ISO 787-18: klasi S2 (<300 µm, mesatare)
- Shkalla e transmetimit të avujve të ujit UNI EN ISO 7783-2: klasi V1 (Sd<0,14 m e lartë)
- Përshkueshmëria e ujit UNI EN 1062-3: klasi W3 (W≤0,1 E ulët)

- Rezistenca ndaj çarjeve UNI EN 1062-7A: klasi A0 (nuk kërkohet)
- Përshkueshmëria në CO2 UNI EN 1062-6: klasi C0 (nuk kërkohet)

Karakteristika të tjera

- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,45-1,6 kg/l
- Viskoziteti UNI 8902: 48000 ± 3200 cps a 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)
- Granulometria maksimale riempitive: 125 µm
- Rezistenca ndaj larjes UNI 10560: >10000 cikle, e shkëlqyer
- Rezistenca ndaj alkaleve UNI 10795: rezistente
- Rezistente ndaj mykut dhe algave sipas UNI EN 15457 dhe UNI EN 15458
- Mbrojtës për fasada në bazë të teorisë së Kuenzle DIN 18550: W<0,5 kg/m²h^{0,5} e Sd<2m
- Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30 min., shtresa tjetër pas rreth 4 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet në suva:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.
- Në praninë e mykut trajtojeni sipërfaqen me detergjent COMBAT 222 kod 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës traspirante/tempera.
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim
- Çarjet duhet të zgjerohen sa duhet dhe të mbushen me llaç, stuko ose produkte të ngjashme.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Plasaritjet dhe uljet mund të trajtohen me BETOMARC 9450150, me RASAMIX

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA

BOJË AKRIL-SILOSANIKE RIEMPITIVA SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË JASHTME ANTIMYK ANTIALGA

seri 634

9440160, me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe aplikoni një shtresë astari akrilik me bazë uji IDROFIS 4700006 ose astar me solvent ISOMARC 4410111 ose astarin e mikronizuar solvent-free ATOMO 8840001. Në suva shumë absorbuese është e mundur që të hidrofobizohet sipërfaqja duke përdorur, si alternativë të ISOMARC, një shtresë NEPTUNUS PRIMER H 0760230.

-Në sipërfaqe jo uniforme mund të aplikohet një shtresë astar riempitiv uniformues akril-silosanik ACRISYL GRIP seri 932 .

-Vazhdoni me aplikimin e ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA sipas udhëzimeve të përshkruara në instruksionet për aplikim.

Sipërfaqe betoni:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Në praninë e mykut trajtojeni sipërfaqen me detergjent COMBAT 222 kod 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun present dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqerë ose bojës transpirante/tempera.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim

-Hiqni pjesët e dëmtuara të çimentos.

-Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe duhet të lyhen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiaccia passivante.

-Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrje me fibra të përforcuara 9490140/130; kryeni ngjijtjen/stukimin përfundimtar me anti-karbonatizuesin anti-tkurrje BETOXAN 200 9.490.120.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe të aplikohet një shtresë astar ISOMARC

me bazë solvent 4410111 ose ATOMO I mikronizuar solvent-free 8840001.

-Në sipërfaqe jouniforme mund të aplikohet një shtresë astar riempitiv uniformues akril-silosanik ACRISYL GRIP seri 932 .

-Vazhdoni me aplikimin e ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

* (Hollimi I astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e mjedisit dhe të sipërfaqes:

-Temperatura e mjedisit: Min. +8 ° C / Max. +35 ° C

-Lagështira relative e mjedisit: <75%

-Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 ° C / Max. +35 ° C

-Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Shmangni aplikimet në sipërfaqe me kondensim ose nën veprimin e drejtpërdrejtë të diellit.

-Për të mos dëmtuar karakteristikat estetike dhe performancën optimale të produktit, rekomandohet aplikimi në kushte klimatike të duhura dhe mbrojtja nga shiu dhe lagështira për rreth 48 orë. Në këtë mënyrë lejohet tharje e plotë e produktit dhe polimerizim i rregullt, që ndodh në rreth 10 ditë.

-Sipërfaqet që preken nga shiu gjatë rreth 10 ditëve, mund të shfaqin vija vertikale të tejdukshme. Kjo nuk ndikon në performancën e produktit dhe mund të hiqet duke e larë me ujë ose me produkte specifike.

-Aplikimi në sipërfaqe me myk, me tretësirë kripërash alkaline ose subjekt i lagështirës në rritje, nuk garanton ngjijtjen e produktit në sipërfaqe, prandaj është e nevojshme ndërhyrja parandaluese e restaurimit të mureve me llaçin kundra-lagështirës NEPTUNUS dhe më pas bojatiseni me sistemin Siloxane NEPTUNUS.

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA

BOJË AKRIL-SILOSANIKE RIEMPITIVA SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË JASHTME ANTIMYK ANTIALGA

seri 634

-Mbrojtja e sipërfaqeve nga myku dhe nga alga është e natyrës koherente: efektiviteti dhe kohëzgjatja janë kushtëzuar shumë nga ekspozimi klimatik dhe mjedisor, nga lloji i ndërtimit dhe nga zgjedhja e sistemit të aplikimit.

-Mjete: pinel, rrul me qime leshi.

-Nr. shtresave: të paktën 2 shtresa.

-Këshillohet që aplikimi I shtresës së parë të bëhet me pinel dhe shtresa e dytë me rrul me qime leshi.

-Hollimi: shtresa e parë 35-40% me ujë; 20-25 % për shtresën e dytë me pinel, 10-15% për shtresën e dytë me rrul me qime leshi.

-Nuk këshillohet aplikimi me airless/ pistoletë për shkak të veprimtarisë gjeryese të komponentëve silicë të produktit.

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Shkalla e mbulimit: 4-5 m²/l për finitura lisho dhe 3-4 m²/l për finitura të ashpra dhe I referohet 2 shtresave në sipërfaqe lisho dhe mesatarisht absorbuese. Është mirë që të përcaktohet shkalla e mbulimit me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie. Produkti gjithashtu mund të ngjyroset me kolorantët COLORADO seri 548. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete. Në ndërhyrjet për jashtë ne rekomandojmë që të përfundoni punimin me materiale të të njëjtit prodhim. Për punë, në të cilat është i pashmangshëm përdorimi i një materiali të ri, mos e aplikoni afër materialit të përdorur më parë. Për rakordimin përdorni ndërprerjet e vazhdimësisë së sipërfaqes, kolonave, mbulesave, skajeve, kablove ose të tjera.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është

ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE Dir. 2004/42/EC)

Cat. A/c: bojë për mure të jashtme të sipërfaqeve minerale (bazë uji): 75 g/l (2007) / 40 g/l (2010)

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA përmban max: 40 g/l VOC

E dëmshme për organizmat ujorë, mund të shkaktojë, në periudhë afatgjatë, efekte negative në mjedisin ujor / Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët / Mos i hidhni mbeturinat në kanalizime / Përdorni veshje mbrojtëse dhe doreza të përshtatshme / Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën. Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të higjienës dhe sigurisë; I lini të thahen mbetjet tërësisht dhe i trajtoni ato si mbeturina të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Bojë akril-silosanike, riempitiva, super e lashme, antialga.

Aplikimi, në sipërfaqe të përshtatshme për bojë kuarc super të lashme akrilike ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA seri 634 me bazë kopolimer akril-silosanik ne dispersion ujor dhe komponentë silicë me granulometri maksimale 0,125 mm, me karakteristika larjeje sipas UNI 10795: e shkëlqyer, përshkueshmëria e ujit likud sipas normës UNI EN 1062-3: e ulët, Në të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

ACRISYL PITTURA RIEMPITIVA

BOJË AKRIL-SILOSANIKE RIEMPITIVA SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË JASHTME ANTIMYK
ANTIALGA
seri 634

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.

Eraldi Shpk